



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E SHëndetësisë
DHE Mirëqënies sociale

BULETINI D M U J O R I

MAJ 2026



► *Asambleja e OBSH, ministrja Sala prezanton prioritetet e Shqipërisë në shëndetësi*

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, në sesionin e 79-të të Asamblesë Botërore të Shëndetësisë dhe gjatë takimeve me homologë të vendeve pjesëmarrëse, theksoi angazhimin e Shqipërisë për ndërtimin e një sistemi shëndetësor më të fortë, modern dhe të qëndrueshëm për qytetarët. Ministrja prezantoi prioritetet kyçe të reformës në shëndetësi, duke theksuar forcimin e kujdesit shëndetësor parësor, transformimin digjital të sistemit dhe investimet në modernizimin e infrastrukturës spitalore, si dhe rritjen e kapaciteteve të personelit shëndetësor.



► *Pavion i ri i traumës në Mirditë, ministrja Sala: Forcojmë sistemin spitalor në veri të Shqipërisë*

Spitali Bashkiak Mirditë po transformohet në një qendër rajonale të traumës dhe rehabilitimit, një model i ri funksional spitalor për Veriun e Shqipërisë, në kuadër të reformës së re spitalore. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof.Evis Sala gjatë inspektimit në Pavionin e ri theksoi se ky investim do të sjellë shërbime të specializuara pranë qytetarëve, duke ulur fluksin në spitalet terciare, veçanërisht në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë, ndërsa bëri me dije se po vijon puna për krijimin e modeleve të ngjashme në zona të tjera të vendit.



▶ Çelet sezoni veror 2026, 301 mjekë dhe infermierë në 36 QSH Verore

Me nisjen e sezonit të ri turistik, 301 mjekë dhe infermierë do të shërbejnë në 36 qendra shëndetësore verore në të gjithë vendin. Kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof.Evis Sala gjatë takimit me personelin mjekësor të sapoemëruar, vlerësuan zgjedhjen e tyre dhe theksuan rëndësinë e ofrimit të kujdesit shëndetësor për çdo turist vendas dhe të tuaj, duke apeluar për angazhim maksimal në garantimin e një sezoni të sigurt dhe të shëndetshëm.



► **Vihet në funksion Akseleratori i 3-të, ministrja Sala: Po punojmë për brakiterapinë dhe Akseleratorin e 4-të**

Vihet në funksion Akseleratori i 3-të Linear në shërbimin Onkologjik në QSUNT, ku është trajtuar me sukses edhe pacienti i parë.

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala tha se ky investim rrit kapacitetet e trajtimit në Njësinë e Radioterapisë dhe përmirëson ndjeshëm cilësinë e shërbimit për pacientët onkologjikë, përmes aplikimit të teknologjive moderne dhe teknikave me precizion të lartë, ndërsa theksoi se po vijon puna për të sjellë brakiterapinë dhe Akseleratorin e 4-të Linear.



► 5-vjetori i Spitalit Memorial, s ë shpejti Shërbimi i Kardiokirurgjisë dhe Kimioterapisë Ditore

Në Spitalin Memorial Fier do të ngrihen dy shërbime të reja, të cilat shënojnë një fazë të rëndësishme zgjerimi të kapaciteteve të tij mjekësore: Kardiokirurgjia me ekip të përbashkët turk–shqiptar dhe Kabineti i Kimioterapisë Ditore, duke rritur ndjeshëm aksesin dhe cilësinë e trajtimeve të specializuara për pacientët. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, në fjalën e saj gjatë ceremonisë së 5-vjetorit të themelimit, vlerësoi rolin dhe funksionimin e Spitalit Memorial si një model suksesi në shërbim të mijëra qytetarëve të jugut, ndërsa bëri me dije se po punohet për shtrirjen e këtij modeli në të gjithë vendin.



► *Dita Botërore e Familjes, ministrja Sala: Mbrojtja e fëmijëve në fokus të reformës sonë sociale*

Në Ditën Ndërkombëtare të Familjes, ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, në një bashkëbisedim me familjet kujdestare dhe birësuese në Shtëpinë e Foshnjës "Hannah dhe Rozafa", vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të familjes në mirëritjen e fëmijëve dhe nismat që qeveria shqiptare po ndërmerr për forcimin e mbrojtjes së fëmijëve. Përmes Fondit Social, Skemës së Ndihmës Ekonomike, procesit të de-institucionalizimit, rrjetit të institucioneve rezidenciale dhe ligjit të ri "Për kujdesin Alternativ në Familje", po ndërtojmë mekanizma konkretë që forcojnë familjen dhe mbështesin mirëqenien e fëmijëve.



► *Milano, Shqipëria prezanton strategjinë kombëtare për implementimin e Inteligjencës Artificiale në shëndetësi*

Gjatë Kongresit European të Inteligjencës Artificiale në Onkologji, organizuar në Milano, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala, prezantoi vizionin e qeverisë shqiptare për transformimin digjital të sistemit shëndetësor, përmes teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, me fokus shërbimin onkologjik. Në fjalën e saj ajo vlerësoi kontributin e diasporës mjekësore shqiptare në këtë drejtim, ndërsa theksoi se Shqipëria është një vend i vogël ku po ndërthuret teknologjia dhe inteligjenca artificiale, duke krijuar një model në rang kombëtar, model i cili mund të aplikohet edhe në vende të tjera.



► *Dita Botërore e Infermierëve, ministrja Sala: Asnjë reformë nuk ka vlerë pa profesionistë*

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala në Konferencën Kombëtare të Profesionistëve të Shëndetësisë vlerësoi misionin dhe kontributin e infermierëve, mamive, teknikëve dhe gjithë profesionistëve të kujdesit shëndetësor në forcimin e sistemit shëndetësor në vend, ndërsa theksoi se roli i tyre është i pazëvendësueshëm në garantimin e kujdesit cilësor për qytetarët.



► ***Siguri Shëndetësore për pelegrinët, shërbim 24 në Kishën e Shën Ndout***

Për herë të parë këtë vit, Qendra Shëndetësore Verore pranë Kishës së Shën Ndout në Laç po ofron shërbim shëndetësor 24 orë gjatë 13 ditëve të martë të pelegrinazhit. Duke nisur nga muaji qershor, kjo qendër do të vijojë funksionimin si qendër shëndetësore verore, duke garantuar kujdes shëndetësor të pandërprerë 24/7 gjatë gjithë sezonit.





REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E SHëndetësisë
DHE Mirëqënies Sociale

BULETINI M U J O R I

MAJ 2026

► **Ministrja Sala me studentët e mjekësisë: IA, një alear i ri në diagnostikë**

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, gjatë një leksioni të hapur me studentë dhe profesionistë të mjekësisë, ndau qasje bashkëkohore mbi rolin e Inteligjencës Artificiale në transformimin e diagnostikës, duke theksuar rëndësinë e përvetësimit të këtyre inovacioneve nga brezi i ri i profesionistëve të shëndetësisë. Ministrja Sala solli një panoramë të evoluimit të diagnostikës ndër vite, duke ndarë me mjekët e rinj eksperiencën e saj profesionale dhe akademike, të zhvilluar në strukturat më prestigjioze mjekësore si Kembrixh, Nju Jork, Itali, etj. në diasgnotikimin e sëmundjeve onkologjike.

